



## **NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

Në zbatim të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Dokumentit me nr. 6694/1 prot., datë 29.12.2023, “Manuali i Burimeve Njerëzore të OST sh.a.”, si dhe Dokumentit me nr. 3329/2 prot., datë 28.05.2021, “Detyrat funksionale dhe kriteret e punësimit për pozicionet e punës në Njësitë Operative dhe Njësinë e Mirëmbajtje Transmetimit” (i rishikuar), OST sh.a. shpall procedurën e rekrutimit për pozicionin e mëposhtëm:

**Teknik/ Specialist** në Sektorin e Telekomunikacionit, Njësia Operative Burrel (NJOB)

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Monitoron, riparon dhe mirëmban sistemet e transmetimit në rrjetin e OST;
- Monitoron, riparon dhe mirëmban rrejtet pasive OPGË, 110/220/400 kV;
- Ndhomon në levizjen, shtrimin dhe instalimin e pajisjeve të telekomunikacionit në rrjetin e OST;
- Teston sistemet e telekomunikacionit për operimin korrekt të tyre;
- Dokumenton aktivitetet e riparimit dhe mirëmbajtjes në mënyrë të kuptueshme;
- Përpunon forma të ndryshme, raportesh dhe korrespondencash dhe i dërgon ato për shqyrtim tek DSHT ne OST;
- Kryhen mirembajtje parandaluese për pajisjet që ka vetë në përdorim si p.sh (veçat e punës instrumenta matëse etj). Ndërmerr veprime konkrete për të rritur sigurinë e funksionimit të pajisjeve në ambjentet teknike;
- Kërkon furnizim me materiale të përshtatshme për të kryer aktivitetet e punës dhe informon për mungesat e pjeseve rezervë;
- Informon SOMRRT ose NMC (Qendrën e Monitorimit të Rrjetit) për defekte të rënda kritike sa herë që ato konstatohen, kryen analizën fillestare të defektit dhe kërkon asistencën në nivelin 2 për zgjidhjen e problemit në bazë të udhëzimeve dhe procedurave;
- Kryen detyra shtesë të ngarkuara nga NJO-të dhe aparati qendror në OST.

### **Kërkesat e përgjithshme, që duhet të plotësojë kandidati për punësim:**

- Të ketë shtetësinë shqiptare;
- Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës sipas kriterëve të miratuara;



- Të jetë i aftë për punë;
- Të mos jetë i dënuar me një vendim gjykate të formës së prerë;
- Të gëzojë integritet moral dhe profesional, si dhe të mos jetë marrë masa disiplinore për cënim të rregullave të etikës;
- Të mos ketë lidhje familjare me punonjës të tjerë të administratës me të cilët kanë lidhje hierarkie;
- Personat që kandidojnë për këtë pozicion, duhet të kenë të paktën 2 -vite eksperiencë pune në fusha relevante.

### **ARSIMI I KËRKUAR:**

Arsimi i mesëm/ i lartë – elektrik/elektronik/informatikë.

### **Dokumentat për dorëzim**

#### **Faza e Vlerësimit**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së Arkivë-Protokollit, në Aparatin Qendror të Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose nëpërmjet postës elektronike: [info@ost.al](mailto:info@ost.al), këto dokumente:

1. Curriculum Vitae (CV)
2. Dëftesë e arsimit të lartë
3. Çertifikime të tjera relevante

Dokumentacioni i dorëzuar nuk do të kthehet mbrapsht, pasi bëhet pjesë e arkivës së Institucionit.

**Afati i dorëzimit të dokumentacionit duhet të bëhet brenda datës 31.03.2024.**

#### **Mënyra e vlerësimit:**

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.



Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët e përzgjedhur.

## **Dokumentat për dorëzim**

### **Faza e lidhjes së kontratës:**

1. Libreza e punës (nëse ka) ose vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore
2. Fotokopje e noterizuar diplomës sëbashku me listen e notave
3. Vërtetim shëndetësor nga Komisioni Mjeko-Ligjor
4. Fotokopje ID
5. Dëshmi penaliteti
6. Vërtetim nga gjykata
7. Vërtetim nga prokuroria
8. Çertifikatë familjare
9. Dëshmi të ndryshme kualifikimi

###